

Raporti Vjetor 2015



**CARITAS
KOSOVA**



PËRMBAJTJE:

I. FJALA HYRËSE

3

II. PROGRAMET

PROGRAMI PËRKUJDESI SHITËPIAK

5

PROGRAMI KUNDËR TRAFIKIMIT ME

6

QENIE NJERËZORE

PROGRAMI NACIONAL I PAQES DHE PAJTIMIT

7

PROGRAMI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

9

PROGRAMI I INTEGRIMIT TË KOMUNITETEVE RAE

11

PROGRAMI PËR SIGURIMIN E USHQIMIT

14

III. PROJEKTET

PROJEKTI PËR RI-INTEGRIMIN SOCIO-EKONOMIK
TË BURGOSURVE

15

PROJEKTI I EDUKIMIT

16

PROJEKTI I ASISTENCËS SOCIALE

17

PROJEKTI PËR RI-ATËDHESIM

18

PROJEKTI I NDËRMARRJEVE SOCIALE

19

INTERVENIMET EMERGJENTE

20

IV. RAPORTI FINANCIAR 2015

21

Përgatiti: *Caritas Kosova*

Dizajnoi: *Lekë Laçi*

Të dashur bashkëpunëtorë dhe mbështetës të Caritas Kosovës!



Misioni i Caritasit në Kosovë është që të përcjell ecjen e njeriut në jetë: ballafaqimet, dhembjen dhe nevojat e tij - të cilat kanë mbetur ende të mëdha, edhe pse vendi ynë nuk është në emergjencë. Pra, Caritasi ka në fokus njeriun dhe dinjitetin e tij gjatë rrugëtimit për të qenë i lirë në kultivimin e virtyteve për një jetë të dinjitetshme. Nga Enciklikat dhe dokumentet zyrtare të mësimit kishtar, ku flitet për rëndësinë e fushës caritative, do të veçoja dokumentin që trajton çështjen e dinjitetit të njeriut - Deklaratën "Dignitates Humanae" (Dinjiteti i Personit).

Kjo Deklaratë i kushton shumë vëmendje dinjitetit të njeriut dhe mbështet veprimtarinë caritative duke porositur qartë që politikat e Caritasit duhet të jenë në përkrahje të *personit njerëzor* pa dallim.

Në këtë kontekst, përgjegjësia dhe puna me përkushtim e punonjësve në fushën caritative duhet konsideruar si mision dhe jo profesion. Në rrugëtimin tonë sfidues, veçanërisht punonjësit e Caritasit ftohen që të shprehin humanizëm në veprimet e tyre profesionale sepse të punosh në Caritas do të thotë të dëshmosh kujdes, dashuri dhe ngrohtësi ndaj çdo njeriu.

Sot, Caritas Kosova është pranë njeriut në nevojë, e posaçërisht atyre të marginalizuar, që çdo ditë me dhembje në zemër kalojnë jetën me shumë pak përkujdesje njerëzore. Caritasi ka një traditë dhe përvojë të gjatë në sferat që i përkasin shërbimit humanitar, duke e pasur për bazë mësimin kishtar: "*Jepini, pra, Cezarit çka i përket Cezarit e Hyjit çka përket Hyjit*" (Mt 22:21). Nisur nga ky parim shohim se Caritasi e ka normë veprimi mësimin kishtar e në forma të ndryshme mbanë përgjegjësi individuale dhe kolektive. Është e qartë që Caritasi nuk pretendon të krijoj sisteme ekonomike, politike e as shoqërore; por misioni dhe përgjegjësia e Caritasit në rrafshin shoqëror përqendrohet në promovimin e dinjitetit njerëzor të përmasave humane, duke u angazhuar në krijimin e një ambienti shoqërorë, ku në fokus të veprimit ka njeriun, të cilit duhet t'i mundësohet kultivimi i vlerave autoktone në përputhshmëri me ato universale.



"Sipas mendimit pothuajse unanim të besimtarëve dhe jobesimtarëve, të gjitha gjërat mbi tokë duhet të jenë të lidhura me njeriun si qendër e tyre dhe kurore (Gadium Et Spes 12;76). Prandaj, Caritasi bënë përpjekje që të mirat e përkohshme të krijuara për njeriun t'i shërbejnë atij për një jetë sa më të dinjitetshme. Në anën tjetër njeriu duhet të shërbehet me këto të mira me falënderim dhe mirënjohje. Meqë të mirat materiale nuk shuajnë etjen që buron në brendësinë njerëzore dhe përvoja e mos ngopjes me të mirat e përkohshme e orientojnë njeriun përtej materializmit.

Apelojmë tek përgjegjësit që të reflektojnë për t'i dhënë mbështetje komponentës sociale, kështu që përmes programeve dhe projekteve Caritasi t'i shoqëroj njerëzit në nevojë duke iu sjellë vlera njerëzore dhe t'i motivoj ata që janë të vetmuar, abuzuar dhe keqtrajtuar. Partnerë dhe bashkëpunëtorë të Caritas Kosovës, në faqet vijuese të këtij raporti mund të lexoni mbi të arriturat e programeve dhe projekteve tona, gjithnjë në mbështetje të njeriut në nevojë e sipas përvojës të rrjetit global Caritas!

Zoti e shpërbleftë bamirësinë Tuaj!

Don Viktor SOPI
Drejtor Gjeneral

**Programi Përkujdesi Shtëpiak**

Prej viti 2009, Caritas Kosova vepron sipas modelit **“Hauskrankenpflege”** të përkujdesit shtëpiak **gjerman** (Caritasi Gjerman); Jemi kujdesur për **1,200 përfituesë**, që janë persona **të moshuar** të sëmurë dhe të vetmuar; **persona me aftësi të kufizuara** dhe persona me **probleme mentale**; **167 personave** u kemi mundësuar një jetë të dinjitetshme deri në çastet e tyre të fundit, të cilët përgjatë vitit 2015 kanë ndërruar jetë. **201,479 shërbime** janë realizuar ku përfshihet sigurimi i terapisë elementare, **shërbime sociale dhe shëndetësore** në nivelin primar, si dhe sigurimi i pajisjeve të ndryshme shëndetësore (shtretër, dysheku anti-dekubitar, etj.)

Stafi përbëhet nga **30 infermiere profesionale** në **14 lokacione**; ndërsa mbështetje ofrojnë edhe **50 vullnetarë** të trajnuar nga trajnerët e Caritas Kosovës; **Partnerë**: Caritasi Gjerman, Ministria e Shëndetsisë, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Caritasi i Zvicrës, Komuna e Ferizajit, Mitrovicës, Klinës, Rahovecit, Malishevës, Vitisë, Shtimës, Drenasit, Gjilanit, Istogut dhe Fushë Kosovës.



Programi Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore

Caritas Kosova në vazhdimësi ka kontribuar në **parandalimin** e trafikimit me qenie njerëzore përmes fushatave kombëtare ndërgjegjësuëse, hulumtime dhe trajnime profesionale me arsimtarë të 16 shkollave fillore në Prizren dhe Ferizaj. Programi ka ndikuar në **ngritjen e kapaciteteve** institucionale të strehimoreve, Qendrave për Punë Sociale dhe Tryezave të Menaxhimit. Të dedikuara për viktimat e trafikimit (fëmijë dhe gra) janë shpërndare pako me **ndihma humanitare** për strehimoret dhe Qendra për Punë Sociale. **Përfshirja sociale** e viktimave të trafikimit si dhe viktimave potenciale është arritur përmes **fuqizimit** të tyre **ekonomik**. **Të drejtat** e 4500 nxënësve janë promovuar dhe **mbrojtur**. Në **konferencën vjetore** sensibilizuese kemi lansuar premierën e filmit “Talking to the Trees” (Duke folur me drunjtë).

Caritas Kosova është **anëtare** në: Autoritetin Kombëtar, Grupin Euro-Mesdhetar dhe rrjetin global COATNET.

Partnerë janë Caritas Franca; Caritas Amerikan (CRS) & Caritas Zvicra.



Programi Nacional i Paqes dhe Pajtitimit

Paqa dhe pajtimi ndër-etnik në Mitrovicë sigurohet përmes përfshirjes sociale, promovimit të të drejtave të njeriut dhe fuqizimit ekonomik të komuniteteve. Me qëllim të **promovimit të drejtave të njeriut** u realizua projekti “Së bashku mund t’ia dalim” financuar nga Ministria për Kulturë Rini dhe Sport. Të rinjtë me nevoja të veçanta nga Qendra Burimore "Nënë Tereza" dhe nxënësit e shkollave në Mitrovicë bashkërisht kanë rritur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri dhe kanë ndikuar në zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Për të nxitur dialogun ndër-etnik dhe shkëmbimin në mes të rinjve u organizua **kampi i përbashkët multi-etnik** në malet e Brezovicës me pjesëmarrjen e të rinjëve shqiptarë dhe serbë, si dhe komunitete tjera. Temë e rëndësishme ishte edhe promovimi i punës **vullnetare** në shoqëri si shprehje e solidaritetit.

Dita Ndërkombëtare e Paqes (21 Shtatori) është shënuar në Mitrovicë me akterë të ndryshëm duke nxitur dialogun ndër-etnik mbi fushën e arsimit.



Kjo tryezë ofroi mundësinë për të debatuar mbi rëndësinë e ngritjes së cilësisë së arsimit formal në rajonin e Mitrovicës, nevojën për të mbështetur arsimin jo-formal, ngritur bashkëpunimin ndëretnik, ndërtimin e besimit, si dhe për të rritur pajtimin dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve të Mitrovicës.

Në nivel nacional Caritas Kosova implementon një projekt të veçantë dedikuar **animacioneve** për fëmijë dhe të rinjë, të cilët bëjnë pjesë në **Rrjetin e Caritasit për Vullnetarë**. Aktualisht ky rrjet përbëhet nga **400 anëtarë** nga Dioqeza dhe rajone të ndryshme në Kosovë duke dëshmuar çdo ditë humanizmin dhe dashurinë në vepër.

Manifestimi i **"10 Milion Yjeve"** u organizua në të gjitha Dekanatet e Dioqezës së Kosovës ku morën pjesë mbi 1000 fëmijë në aktivitete të ndryshme si: vizatim, recital, shfaqje teatrale dhe vallëzim. Dita finale e kësaj ngjarje kishte grumbulluar mbi 300 fëmijë, të rinjë dhe vullnetarë nga të gjitha rajonet e Kosovës, të cilët me moton **"Paqja fillon me një buzëqeshje. Buzëqesh!"** përçuan mesazhe të paqes. **Partner** është Caritas Franca.



Programi për Personat me Aftësi të Kufizuara

Gjatë vitit 2015 Caritas Kosova në partneritet me HANDIKOS-in dhe Qendrën Kosovare për Vetë-Përkrahje kanë zbatuar projektin “Personat me aftësi të kufizuara për një jetë më të mirë – **POWER**”, të financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Caritas Italiana. Projekti kishte për synim: fuqizimin e shoqatave që merren me aftësinë e kufizuar, ngritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën dhe qeverisjen e shoqatave të tyre, si dhe ngritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet lokale.

Gjatë zbatimit të projektit janë realizuar aktivitete të ndryshme si: punësimi i personave me aftësi të kufizuara; **30 komuna** të Kosovës dhe **60 zyrtarë** komunal janë trajnuar mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionalitetit; zhvillimi i kapaciteteve të anëtareve të shoqatave të personave me aftësi të kufizuar; krijimi i **9 Grupeve Ndër-Sektoriale** për vlerësimin dhe monitorimin e Planeve (Nacionale/Lokale) të Veprimit për aftësinë e kufizuar;



diskutimi dhe shkëmbimi e përvojave në tema të ndryshme në nivel regional dhe komunal; reduktimi stigmatizimi; si dhe sensibilizimi i masës së gjerë gjatë ditëve ndërkombëtare mbi aftësinë e kufizuar. Caritas Kosova ka përkrahur në aspektin e **punësimit dhe përfshirjes sociale** personat me nevoja të veçanta në rajonin e Pejës përmes avokimit dhe lobimit në kuadër të projektit "**STEP**". Ky projekt financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Caritas Italiana. **Qendra e Caritasit për Edukim & Detektim** të hershëm në Prizren kujdeset për mbi 40 fëmijë me aftësi të kufizuara, si dhe për prindërit e tyre. Ofrohet veçanërisht kujdesje profesionale për fëmijë me **autizëm**. Është mundësuar aftësimi profesional i fëmijëve me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe të folur të qendrës burimore në sektorin e bizneseve private. **Partnerë** janë Caritas Insbrukun, Caritasin Çek, Ambasadën Çeke dhe Agjensionin Austriak për Zhvillim.



Programi i Integritit të Komuniteteve RAE

Programi për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) realizohet për mes **dy qendrave edukative të Caritasit** në Ferizaj dhe Gjakovë, si dhe **dy komponentë** tjerë të programit që implementohen në Prizren dhe Mitrovicë. **Qendra Sociale dhe Edukative** në fshatin Dubravë të Ferizaj mbështetë 215 nxënës të shkollës fillore me mësim plotësues dhe animacione, duke përfshirë edhe kurse në matematikë, gjuhë angleze dhe informatikë. **Aktivitete kulturore dhe sportive** me grupet rinore dhe vullnetarë të Caritasit u organizuan përgjatë vitit 2015, si dhe: shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, "10 Milion Yjet," ekskursione me karakter edukativ (monumente kulturore dhe religjioze).

Kopshti i fëmijëve në Dubravë realizon programin edukativ për 55 fëmijë. Në kuadër të qendrës ofrohen edhe shërbime shëndetësore ku gjatë vitit 2015 janë realizuar **4085 shërbime të mjekësisë primare**, si dhe **867 shërbime stomatologjike** për tërë komunitetin RAE në Dubravë. Qendra posedon edhe **Bibliotekën Interaktive** me libra të ndryshëm, që u mundësua nga Këshilli i Evropës. **Partner strategjik** është Komuna e Ferizajt.



Në Qendrën e Caritasit të Komuniteteve "Ali Ibra" në Gjakovë për 120 fëmijë ofrojmë aktivitete edukative(parafillor dhe fillor), sportive dhe kulturore, asistencë për ri-integrim e nxënësve në procesin e rregullt mësimor, shërbime shëndetësore, edukim shëndetësor, aktivitete psiko-sociale, trajnime të ndryshme dhe përkrahje administrative në drejtim të institucioneve për shërbimeve publike.

40 fëmijë të moshave 4 deri 6 vjeç vijnë në **mësimin parashkollor** në qendrën e komuniteteve. Përmes asistencës me **detyra të shtëpisë**, ku marrin pjesë rreth **80 nxënës** të shkollave fillore, është arritur me punë intensive që këta fëmijë të zhvillohen në aspektin mësimor dhe socializues. Grupi i përbërë prej **15 fëmijëve që kanë braktisur shkollën** fillore me ndihmën e edukatoreve punohet në aspektin psiko-social për të mundur qasjen e tyre të serishme në procesin e mësimor dhe përfshirjen e tyre sociale. Deri në **50 pacientë** trajtohen rregullisht nga infermieret e projektit "Përkujdesja Shtëpiake" (Home Care), të cilat po ashtu organizojnë takime sensibilizuese mbi shëndetin dhe shpërndajnë materiale përkatëse informuese. Në bashkëpunim me QKMF në Gjakovë **janë vaksinuar 150 fëmijë** të lagjes Ali Ibra. **Aktivitete sportive** organizohen në vazhdimësi në nivel komunal dhe regional, ku ekipet marrin pjesë në turnire të ndryshme multi-etnike. Të rinjtë e lagjes në shumicën e lojërave janë shpërblyer me vendet e para.

Caritas Kosova ka ndërmjetësuar edhe në regjistrimin e të rinjëve në programet e Qendrës së Aftësimi Profesional në Gjakovë. **Partnerë** janë Caritas Zvicra dhe Komuna e Gjakovës.



Në **Prizren** kemi mbështetur 50 të rinjë të komuniteteve RAE me mësim plotësues, masa parandaluese për braktisjen e shkollës, trajnime (lidërsip, përfaqësim, lobim) dhe vizita studimore në rajon. Ndër tjerash, 25 gra janë aftësuar në fushën e shëndetit. **Plani Lokal i Veprimt** është monitoruar në vazhdimësi dhe kemi arritur alokim e fondeve komunale për komunitete RAE. **Partnerë** janë Caritas Zvicra dhe Caritasi Çek.

Në lagjen "2 Korriku" dhe "Mahallën e Romëve" të **Mitrovicës** Caritasi ka reduktuar analfabetizmit e 20 grave të komuniteteve RAE.

50 nxënës të ciklit fillor dhe atij të mesëm përfunduan me sukses trajnimet mësimore dhe u certifikuan nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Me qëllim të përfshirjes së fëmijëve RAE në shkollë të rregullt, Caritas Kosova ka mbështetur **70 fëmijë** (3-10 vjeç) përmes projektit "Portage." Përfitues janë edhe **300 të rritur**, kryesisht prindër dhe pjesëtarë të komuniteteve, që bëjnë pjesë në "Iniciativën të jesh prind më i mirë" (Better Parenting Initiative). **Partnerë** janë DRC, UNICEF-i dhe Caritas Franca.



Programi për Sigurimin e Ushqimit (zhvillimi i agrikulturës)

Në kuadër të fushatës globale së Caritas Internationalis kundër urisë në botë, Caritas Kosova ka fuqizuar **sektorin e bujqësisë** dhe **ndërmarrjet familjare** të vogla dhe të mesme në zonat rurale të Leposaviqit dhe Mitrovicës.

Deri në **300 fermerë** të të gjitha komuniteteve do të përfitojnë nga realizimi i kësaj faze të projektit. Kryesisht gra dhe të rinj kanë përfituar pako/pajisje bujqësore në sektorin e bletarisë, pemëtarisë dhe perimtarisë, blegtorisë si dhe zhvillimit rural.

Po ashtu fermerët vazhdojnë të përfitojnë nga trajnimet profesionale, vizitat studimore në rajon dhe organizimin e panaireve për **promovimin e prodhimeve vendore**. **Partnerë** janë Caritasi Belg dhe Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar



Projekti për Ri-integrimin Socio-ekonomik të Burgosurve

Gratë dhe të rinjtë e Qendres Korrektues ne Lipjan jane perkrahe nga ky projekt i "Caritas Kosova qe nga viti 2013. **2 gjenerata të grave** "kane "perfunduar me sukses **trajnimet e certifikuara**"per aftesim profesional ne "flokatori dhe rrobaqepesi; Periodikisht "jane organizuar **aktivitete rekreative**"per te rinj me vullnetare te Caritas Kosoves;"Ne vitin 2015 "eshte organizuar **konferenca**"me temen: "Ndikimi i projekteve sociale ne rehabilitimin dhe re-integrimin e personave te burgosur."

"Ne kuader te konferences eshte realizuar edhe **ekspozita** me titull "'Perjetime' me piktura nga nje i mitur ne Qendren Korrektuese ne Lipjan, 'ku jane perçuar mesazhe sensibilizuese tek te rinjte dhe opinioni i gjere.

Partner"eshte Caritas Franca.



Projekti i Edukimit

“Caritas Kosova është perkushtuar”ne **sigurimin dhe rritjen e cilësisë në fushën e edukimit.**

“Duke qene nje nder çerdhet me te medha ne Kosove, edhe gjate vitit 2015 “ka vazhduar punen “Çerdhja e rë” ne Ferizaj,”e cila ka nje numer prej mbi **250 fëmijëve** me grup-moshat nga **6 muaj deri 6 vjeç.**

“Aty jane te angazhuar **ekipe profesionale**”qe”hapesiren prej 1.172 m2 e “shnderrojne ne nje **ambient shumë të dashur**”per femije.

Partner”ne kete projekt eshte Komuna e Ferizajit.



Projekti i Asistencës Humanitare

Më shumë se **500 familje** që jetojnë në varfëri ekstreme janë mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Caritas Kosova me ushqim, veshmbathje dhe mobile. Me **mijëra përfitues** janë ndihmuar përmes shpërndarjes decentrale, ku institucionet e ndryshme kanë ndërmjetësuar, siç janë: **Kisha Katolike** në Kosovë: famullitë, kongregatat, menza për të varfër si dhe çerdhe për fëmijë. **Organizata të ndryshme:** OJQ për njerëz me nevoja të veçanta, Shoqata të pensionerve (Ferizaj, Shtime, Suharekë), Shoqata e Invalidëve të Punës në Viti, SOS fshati; Shoqata e të shurdhërve në Gjakovë, Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve (Ferizaj, Reçak), Shoqata humanitare "Pashtriku" në Prizren, klubet sportive; si dhe përfitues të projekteve të Caritasit - Qendra Sociale Edukative Dubravë. **Institucione:** shkollat, strehimorja kolektive në Dubravë, Instituti Special në Shtime, spitalet regjionale, qendrat e mjekësisë familjare, shtëpitë e të moshuarve, Shtëpia Integruese në Bashkësi (Ferizaj), QKUK në Prishtinë; qendrat për punë sociale (Ferizaj, Shtime, Fushë Kosovë), drejtoritë komunale (Kaçanik, Malishevë, Shtime), Policia e Kosovës dhe Qendra Korrektuese në Lipjan. **Partner** që nga viti 1999 janë vullnetarët e organizatës "Junge Leute Helfen."



Projekti për Ri-atëdhësim

Migrimi mbetet një plagë e përhershme e familjeve Kosovare, të cilat për arsye të ndryshme braktisin vendin, qoftë për të siguruar mbijetesën apo edhe një jetë më të mirë. Edhe në vitin 2015 për personat e kthyer nga Belgjika dhe Holanda Caritas Kosova ka siguruar grante për themelimin e një **ndërmarrje familjare**.

Ndërsa për raste **sociale dhe vulnerable** si dhe atyre me probleme **shëndetësore**, varesisht prej nevojave të paraqitura, janë ofruar fonde përkatëse.

Edhe pas ndihmes financiare, të gjithë përfituesit vazhdojnë të perkraken nga Caritas Kosova deri në **12 muaj** sipas kërkesave të parashtruara.

Partnerë janë Caritasi Belg dhe organizata Matverk bij Terugker.



Ndërmarrjet Sociale

“Gjate vitit 2015 Caritas Kosova, ne bashkepunim me partnere dhe ekspert nga Italia, ka kontribuar ne **draftimin e ligjit** “aktual per “ndermarrjet sociale”ne Kosove. “Ne kuader te projektit jane zhvilluar **3 punëtori, një konferencë dhe 2 vizita studimore**”ne **6 shtete të rajonit** “per te pare praktikat e mira si dhe mundesite e transferimit te pervojave te “ngjashme ne Kosove. Caritas”Kosova ka krijuar kushtet dhe ka mundesuar themelimin e **3 ndërmarrjeve të reja sociale**”te udhehequra teresisht nga organizata dhe grupe rinore te Dioqezes se Kosoves. “Keto ndermarrje sociale **synojnë direkt grupet e marginalizuara**”duke i punesuar ato apo “duke ju ofruar sherbime te ndryshme me kushte te lehtesuara. **Partnerë** “ne kete iniciative të“re jane Konferenca Ipushkvnore Italiane dhe Caritas Italiana.



Intervenimet Emergjente

Sipas Plani Strategjik 2013-2017, Caritas Kosova ka themeluar **sektorin e veçantë për intervenim** në raste emergjente.

“Qe nga viti 2009 jemi bashkethemelues dhe anetare e grupit rajonal **SEECEG**.” Në kete kontekst eshte hartuar **Plani Nacional** i Caritas Kosoves për **Veprim në emergjenca**.


“Caritasi aplikon metodologjine Reduktimi i Rreziqeve nga Katastrofat (“Disaster Risk Reduction” **DRR**) si dhe Standardet e Caritasit (**SPHERE**).

10% e stafit dhe 15% e vullnetarëve të Caritas Kosoves jane te trajnuar profesionalisht per raste emergjente.

Partnerë kemi Caritas Internationalis dhe Caritas Europa.




PËRQINDJET SIPAS PROGRAMEVE

**BUXHETI VJETOR 2,415,977.19€**

- 49% Programi Përkujdesi Shtëpiak
- 3% Programi Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore
- 4% Programi Nacional i Paqes dhe Pajtimit
- 7% Programi për Personat me Aftësi të Kufizuar
- 11% Programi i Integrimin të Komunitetit RAE
- 9% Programi për Sigurimin e Ushqimit
- 1% Projekti për Ri-integrimin Socio-Ekonomik të Burgosurve
- 10% Projekti i Edukimit
- 1.5% Projekti i Asistencës Sociale
- 1% Projekti për Ri-atëdhësim
- 2% Projekti i Ndërmarrjeve Sociale
- 3% Struktura e Caritas Kosovës

PËRQINDJET SIPAS DONATORËVE



- 21% Caritas Network
- 54% Komunat
- 4% Bashkimi Evropian
- 2% Ministritë
- 7% Ambasadat
- 12% Tjera

VLERE MONETARE


41,310.00 €

VLERE MATERIALE

196,20 TON

Shënim: NDIHMA HUMANITARE

[illegible]



www.caritaskosova.org

Zyra Regjionale
Rr. Papa Gjon Pali II nr.1
20 000 Prizren, Kosovë
tel.+381(0) 29/244 875

Zyra Qendrore
Rr. Rexhep Bislimi, Kisha Katolike
70 000 Ferizaj, Kosovë
tel.+381(0) 290/328 110
fax. +381 290/396 588
[e-mail:info@caritaskosova.org](mailto:info@caritaskosova.org)

Zyra Regjionale
Rr. Tirana nr.101
40 000 Mitrovicë, Kosovë
tel.+381(0) 28/530 250